



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 582/4 Prot.

Tiranë, më 19.02.2025

**VENDIM**

Nr. 12 Datë 19.02 2025

**“PËR  
MIRATIMIN E PËRJASHTIMIT NGA TARIFA E SHKOLLIMIT ME 50% PËR  
STUDENTËT E CIKLIT TË II QË PLOTËSOJNË KRITERET, PËR VITIN  
AKADEMIK 2024-2025 NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Mbështetur në nenin 49 të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të VKM nr. 780 dt. 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimeve në programet e ciklit të dytë të studimeve, në IAL Publike"; Vendimit të Bordit të Administrimit nr.32 datë 07.08.2024 "Mbi miratimin e tarifave të shkollimit për të tre ciklet e studimeve, në Universitetin e Sporteve të Tiranës", në Vendimin Nr. 41 datë 31.10.2024 "Për Miratimin e formularëve për përfitim burse, përjashtim nga tarifa shkollimit për ciklin e parë të studimeve, reduktim 50% nga tarifa e shkollimit për ciklin e dytë të studimeve për vitin akademik 2024-2025 në Universitetin e Sporteve të Tiranës, në Relacionin nr.492 datë 07.02.2025 "Mbi shqyrtimin e dokumentacionit përkatës për përjashtim 50% nga tarifa e shkollimit për ciklin e dytë të studimeve" në Relacionin e Administratorit nr.518 prot, dt 10.02.2025

Bordi i Administrimit ,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e listës shtesë të studentëve që ndjekin studimet në Ciklin e Dytë të studimeve, program i parë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për tu përjashtuar 50% nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2024-2025 kriteri 3, tabela bashkëngjitur;
2. Efektet financiare për studentët që kanë aplikuar brenda afateve të përcaktuara fillojnë nga fillimi i vitit akademik 2024-2025, dhe studentët që kanë aplikuar pas afatit 15.12.2024 llogariten sipas datës së aplikimit.
3. Ky vendim bashkë me listën e studentëve që përfitojnë dhe me efektet financiare duhet të dërgohet në MAS dhe AKFAL.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria e Financës dhe Buxhetiti, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademike-Shkencore të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) dhe tek transparenca universitare.

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**Artur ÇOBANI**



**Kriteri nr. 3:** Student qe vjen nga shtresa sociale : Studentet qe familjet e te cileve trajtohen/perfitojne ndihme ekonomike te plote apo te pjesshme nga njesite baze te vetqeverisjes vendore .

Nr.	Nr. matrikullimi	Emër Mbiemër	Nr. prot.	Data	Fakulteti	Programi	Viti	Efekt i Financiar
1	EF813B120014	F. B	3301/16	05.12.2024	FSHL	MEFSH	2	52,500
2	EF813B130021	J. G	3301/8	05.12.2024	FSHL	MEFSH	1	52,500
<b>Totali</b>								<b>105,000</b>

Eduard Meçaj

